



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 139, datë 30.09.2020

**PËR
MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË STATUTIT TË SHOQËRISË “ALBSIG INVEST-
SHOQËRI ADMINISTRUESE E FONDEVE TË PENSIONIT DHE SIPËRMARRJEVE
TË INVESTIME KOLEKTIVE” SH.A**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 22, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, nenit 20, të Ligjit nr. 56/2020 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”, si dhe të nenit 25 pika 4, të Rregullores nr. 112, datë 31.08.2020 “Për licencimin dhe rregullat shtesë të licencimit të shoqërive administruese të fondeve, depozitarëve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive, licencimin dhe regjistrimin e sipërmarrjeve të investimeve kolektive të themeluara në Republikën e Shqipërisë”, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I :

- 1. Miratimin e ndryshimit të nenit 5, pika 1, të statutit të shoqërisë “Albsig Invest-Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive” sh.a., si rezultat i rritjes së kapitalit, si më poshtë:**

“5.1 Kapitali i nënshkruar dhe tërësisht i paguar i shoqërisë është 54,000,000 (pesëdhjetë e katër milion) lekë, i cili përbëhet nga 54,000 (pesëdhjetë e katër mijë) aksione të zakonshme me vlerë nominale prej 1,000 (një mijë) lekë secili. Kapitali është nënshkruar dhe paguar si më poshtë:

5.1.1 Shoqëria “Albsig Jetë” sh.a., zotëron 54,000 (pesëdhjetë e katër mijë) aksione të cilat përbëjnë 100 % (njëqind për qind) të kapitalit të shoqërisë”.

- 2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit, për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ANËTAR

Deniz DERALLA

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV

Ervin METE